



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 167, datë 18.12.2020

PËR

**MIRATIMIN E PROJEKTIT “MBËSHTETJE FINANCIARE (GRANT) PËR
BIZNESE TË REJA “TË GJELBËRTA” TË CILAT BAZOHEN NË NJË MODEL
EKO-MIQËSOR, OSE BIZNESE EKZISTUESE TË CILAT TENTOJNË TË
SHNDËRROHEN NË BIZNESE “TË GJELBËRTA” DUKE FUTUR ELEMENTË
GO-GREEN NË TO**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9 pika 1, nënpika 1.1 shkronja “b”, nenit 28, pika 6, nenit 54 shkronja “k”, nenit 55 pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për Ndihmën Shtetërore” i ndryshuar, Vendimit të Komisionit të Ndihmës Shtetërore nr. 99, datë 16.10.2020 “Autorizim i ndihmës shtetërore “Mbështetje financiare (Grant) për biznese të reja “Të Gjëlbertha”, të cilat bazohen në një model eko-miqësor, ose biznese ekzistuese të cilat tentojnë të shndërrohen në biznese të “Gjëlbertha” duke futur elementë Go-green në to”, si dhe në vijim të Memos me nr. 42608 prot., datë 03.12.2020, të Drejtorisë së Përgjithshme të Projekteve Strategjike dhe Zhvillimit Ekonomik drejtuar Kryetarit të Bashkisë, me lëndë “Mbi procedurën e miratimit me Vendim të Këshillit Bashkiak të projektit “Mbështetje financiare (grant) për biznese të reja “të gjëlbertha” të cilat bazohen në një model eko - miqësor, ose biznese ekzistuese të cilat tentojnë të shndërrohen në biznese “të gjëlbertha” duke futur elementë go-green në to”,

V E N D O S I :

1. Miratimin e projektit “Mbështetje financiare (grant) për biznese të reja “Të Gjëlbertha” të cilat bazohen në një model eko-miqësor, ose biznese ekzistuese të cilat tentojnë të shndërrohen në biznese “Të Gjëlbertha” duke futur elementë Go-Green në to”, hartuar sipas Udhëzuesit operacional për zbatimin e tij, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
 2. Efektet financiare, sipas pikës 1 të këtij vendimi, në shumën prej 12.000.000 (dymbëdhjetë milion) lekë /për vit, do të përballohen nga fondi për programin “Mbështetje për Zhvillimin Ekonomik” të parashikuar në Buxhetin e Bashkisë Tiranë për vitin 2021-2023”.
 3. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Përgjithshme e Projekteve Strategjike dhe Zhvillimit Ekonomik, Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licencimit dhe Drejtoria e Përgjithshme për Marrëdhëniet me Publikun dhe Jashtë, për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

K R Y E T A R

ROMINA KUKO